



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:190756
Datë: 13.03.2025
Numri i dokumentit: 06981850

Ac.nr.7090/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët - Faton Ademi kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.M), F.M, M.P, R.T dhe R.A, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit B.P, avokat në V....., rruga “D..... e K.....” p.n., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në P....., Rruga “L..... H.....” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.6872/21, i datës 16.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2025 mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovë, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.6872/21, i datës 16.03.2023 **VËRTETOHET**.
- II.** Pika e III-të e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar mbetet e pa shqyrtuar

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.6872/21, i datës 16.03.2023, ka vendosur si në vijim: I APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve R.M), F.M, M.P, R.T dhe R.A, ashtu që DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme,

Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t'ua paguajë shumat si në vijim:

- Paditësit të parë R.M , në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguajë për çdo vit shumën nga 531.90 €, e në total, shumën prej 2,127.60 €.

- Paditësit të dytë F.M , në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguajë për çdo vit shumën nga 620.00 €, e në total, shumën prej 2,480.00 € dhe në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,654.07 €.

- Paditësit të tretë M.P në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguajë për çdo vit shumën nga 373.56 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,494.24 €.

- Paditësit të katërt R.T , në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguajë për çdo vit shumën nga 563.31 €, e në total, shumën prej 2,253.24 €, dhe në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune shumën prej 142.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,395.24 €.

- Paditësit të pestë R.A , në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguajë për çdo vit shumën nga 571.90 €, e në total, shumën prej 2,287.60 € dhe në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune shumën prej 142.00 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,429.60 €.

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, t'ju paguajë paditësve R.M), F.M , M.P , R.T dhe R.A , shumat e gjykuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data 27.07.2021 kur është paraqitur padia në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit.

III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë e paditësit F.M për kompensimin në emër të shpërblimit jubilar përtej shumës së gjykuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumën prej 110.93 €, ndërsa në tërësi refuzohet kërkesa e paditësve R.M dhe M.P, për kompensimin e shpërblimit jubilar prej 25 % të një page bazë në shumë prej 142.00 €. Po ashtu në tërësi refuzohen kërkesat e paditësve, me te cilat kanë kërkuar për ta detyruar të paditurën që paditësve t'ju paguajë në emër të shujtave ditore nga 3.00 € për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022, apo për 740 ditë të punës dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00 €, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura *për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale* me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën e të paditurës në tërësi si të bazuar të ndryshohet aktgjykimin e ankimuar C.nr.6872/21, i datës 16.03.2023 si dhe të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësv.

Përgjigje në ankesë kanë bërë paditësit me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.6872/21 të datës 16.03.2023 ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 par.1 pika d) lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësit R.M,F.M, M.P, R.T dhe R.A, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 27.07.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, për pagesën e shpërblimit për fund vit, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, dhe parashtrësë për precizim të padisë me datën 22.03.2022.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.6872/21 të datës 16.03.2023 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, ka theksuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura, nuk është kontestues përvoja e punës së paditësve tek e paditura, lartësia e pagës së paditësve për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, si dhe prezenca e tyre në punë nga data 14.11.2018 e deri me 23.03.2022,. Po ashtu nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga formulari i vlerësimit të performancës vërtetohet fakti se paditësi, R.M nga data 12.01.2004 është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës referencës 04/1-04-SRR-A/500/2021 i datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 531.90E Paditësit V. F.M nga data 24.07.2000 është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 04/1-04-A/491/2021 të datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 639.60 €, Paditësja M.P nga data 27.09.2004 është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/495/2021 i datës

22.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 418.70 €, Paditësi R.T nga data 24.09.2001 është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/490/2021 i datës 22.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 580.24€, Paditësi R.A nga data 15.04.2002 është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/548/2021 i datës 23.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 571.90€.

Gjykata, provave të lartcekura, me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien e punës të paditësve tek e paditura, vlerësimet e performancës së punës dhe lartësinë e pagave të paditësve, ua fali besimin e plotë dhe të njëjtat i pranoi si prova materiale, në kuptim të nenit 329, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuar nga vet e paditura.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se e paditura ka pasur detyrim që paditësit si i punësuar i saj t'ia paguajë pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi janë plotësuar kushtet nga ana e paditësit siç parashihen me nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, me saktësisht, vlerësimi i performancës për vitet 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtëve nuk janë shqiptuar asnjë masë disiplinore. Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë për kompensimin e ushqimit (shujtave ditore), pasi që në vlerësimin e gjykatës paragrafi 1 i nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe paragrafi 1 i nenit 30 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, nuk kanë karakter detyrues dhe si të tilla nuk e obligojnë të paditurën për pagesë të shujtave ditore të pretenduar nga paditësit si në padi.

Vendimin e ka bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Lidhur me kumatën e gjykuar, gjykata e shkallës së parë iu është referuar nenit 382.2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit, 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike

dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në raport me pretendimin për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike po ashtu kjo nuk qëndron, sepse nga provat e administruara dhe vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar këto fakte: punësimi i paditësit te e paditura, vlerësimi pozitiv i paditësit nga e paditura për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore, lartësia e pagave është vërtetuar me dokument zyrtar siç është lista e pagave dhe është bazuar në pagën e muajit dhjetor për vitet kontestuese (ku në bazë të listës së pagave, dhe vendimeve të të paditurës, vërtetohet se shuma e përgjithshme për katër vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 është shuma si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar), e paditura nuk ka arritur të provojë se ia ka kompensuar paditësve pagat e kërkuara.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e procedurës nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditësit nuk hyn në kategorinë e çështjeve për tu ngritur konform nenit 78 fillimisht te e paditura e më pastaj konform nenit 79 në gjykatë, për arsye se nga ana e punëdhënësit nuk ka ndonjë vendim paraprak të cilin do ta godiste paditësin, por ka detyrim të përmbushjes nga ana e të paditurës.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës ne Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29.1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2. përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore ne fund te vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi janë në marrëdhënie pune te e paditura, nuk ka pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestuese, 2018, 2019 2020 dhe 2021, ndërsa ka pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 26.05.2021, dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën III të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7090/2023, me datë 11.03.2025

Kryetar i Kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi d.v